

VENDIM
Nr.797, datë 12.12.2022

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.935, DATË 25.11.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR
FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTEA
(PALLAT) DHE BANESAVE INDIVIDUALE, NË BASHKITË DURRËS DHE
LEZHË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 4/1, të vendimit nr.935, datë 25.11.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 4/2, me këtë përmbajtje:

“4/2. Përdorimi i fondit të rindërtimit, për vitin 2022, nga Bashkia Durrës, për financimin e riforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, është në masën 261 381 097 (dyqind e gjashtëdhjetë e një milionë e treqind e tetëdhjetë e një mijë e nëntëdhjetë e shtatë) lekë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, dhe i transferohet Bashkisë Durrës në formën e transfertës së pakushtëzuar.”

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku